

## 5.2 HYRJA NË DEPARTAMENTIN PËR HUAZIM

Në bibliotekat, të cilat procesin e huazimit e kanë të organizuar sipas departamenteve, pas hapjes së programit COBISS3 duhet të hyni në atë departament, të cilin administratori juaj, përmes portalit Kualifikimi e ka përzgjedhur si të paracaktuar për emrin tuaj të përdoruesit. Nga një departament në tjetrin mund të kaloni edhe pas hapjes së programit COBISS3, nëse për këtë keni autorizimet e nevojshme.

### *Procedura*

1. Në pjesën e dritares me modulet dhe klasat përzgjidhni klasën **Departamenti** (në modulën Huazimi ose Administrimi i aplikacioneve).
2. Përzgjidhni metodën **Klasa / Kalimi në departamentin tjetër**.  
Hapet dritarja **Përgjedhja e departamentit** me listën e departamenteve, në të cilin keni qasje me emrin tuaj të përdoruesit.
3. Përzgjidhni departamentin dhe klikoni butonin **Në rregull**.

Në shiritin e titullit shfaqet simboli dhe emri i departamentit, në të cilin keni hyrë.

### *Mundësitë...*

Nga departamenti në të cilin ndodhëni mund të kaloni në departamentin tjetër përmes metodës **Sistemi / Parametrat / Departamenti për huazim**.